



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 763 prot.

Memaliaj më 01.04.2025

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 01. 04. 2025 në sallën e mbledhjeve të këshillit, kati i parë i bashkisë Memaliaj.

Mbledhja drejtohet nga kryetari i këshillit z. E. Sinanaj.

Në momentin e fillimit të mbledhjes 10 këshilltarë.

Ora e fillimit të mbledhjes 11:00. Mbledhja deklarohet e hapur nga kryetari i këshillit.

Njohja me rendin e ditës.

1. P/Vendim“ Miratimin planit operacional për vitin 2025 ne fondin pyjor dhe kullosor të Bashkisë Memaliaj“.

2. P/Vendim “Për miratimin e siperfaqes së tokës bujqësore që do jepet me qera” miratimi i rendit të ditës.

• Pika e parë e rendit të ditës: Projekt vendim“ Miratimin i rendi të ditës“

Vota Pro 10

Vota Kundër -

Vota Abstenim -. Miratohet.

• Pika e dytë e rendit të ditës: Projekt vendim“ Miratimin planit operacional për vitin 2025 ne fondin pyjor dhekullosor të Bashkisë Memaliaj“.

Relaton z. Beqar Xhaferi sipas relacionit bashkangjitur.

Vjen në mbledhje znj. Afize Sula.

Diskutime: Ky si plan kalon në parim. Pse lindi nevoja për të pasur një plan këtë vit?

B. Xhaferi: Nuk kemi pasur një inxhinier pyjesh për të hartuar një plan. Nga ministria e bujqësisë na është lënë detyrë.

E. Xhemali: pika 1.6 thotë brenda muajit shkurt dhe ne jemi në prill.

T. Rama: Ne nuk kemi pasur një plan dhe ky është fakt, data nuk prish punë.

P. Lumani: Unë e kuptoj që duhet të hapim rrugë, mendoj që ta kalojmë duke qenë shpresëplotë që administrata do t'i ketë parasysh kërkesat tona.

A. Muçolli: Më është thënë që ka afat kohor nga ministria të vihemi në dijeni. Ne nuk e kaluam sepse nuk ishim të qartë dhe relacioni ishte i njëjtë. Pashë te tabelat që janë copy paste. Administrata duhet të jetë e kujdesshme në tabeleën nr. 4 nuk është totali.

Janë përcaktuar m² dru zjarri do të priten.

Xh. Beqari: Do të kalohet plani dhe pastaj do të bëhet plani mbarështimit.

E. Sinanaj: Do të donim një saktësim të zonave?

Xh. Beqari: Janë të ndara sips ekonomive kjo i përket planit të mbarështimit. Kjo do të vijë në një moment të dytë.

P. Lumani: Unë mendoj se kjo mbledhje po hap rrugë për një plan më të detajuar dhe informacion nga administrata.

A. Malaj: Ky plan kërkonte ekspert dhe ne e kemi kontaktuar dhe ai ka kosto dhe kërkon një kosto për të hartuar planin e mbarështimit. Kullotat nga viti në vit po teprojnë se blegtorët janë në tkurrke.

E. Sinanaj: Z. Kryetar duam që nga ana e administratës të jenë më kompetentë në dokumentacionin që sjellin.

Hidhet në votim.

Vota Pro 9

Vota Kundër -

Vota Abstenim 2 Irena Jaupi dhe E. Xhemali . Miratohet.

● Pika e tretë e rendit të ditës: Projekt vendim: "Për miratimin e sipërfaqes së tokës që do të jepet me qera."

Relaton z. B. Xhaferi sipas relacionit bashkangjitur.

Diskutime: A janë verifikuar që janë të pambjella?

B. Xhaferi: Tokat që janë sjellë kësaj here janë të verifikuara që janë tokë shtet.

A. Malaj: Ne në bazë të kërkesave, verifikojmë sipas numrave të pasurisë dhe kërkojmë leje në parim për të kaluar më pas në ankand sipas ligjit.

Jemi duke ndërmarrë një iniciativë dhe po verifikojmë të gjitha tokat e zaptuara dhe t'u vjelim të ardhurat. Largohet nga mbledhja E. Xhemali.

P. Lumani: Realisht kam ardhur me tjetër koncept këtu në qoftë se do të kujtoheni këto projekte kanë ardhur dhe herë tjetër. Po duke besuar kryetari ne do ta kalojmë këtë, por formalisht këto toka janë të mbjella. Mua më vjen mirë po do të kisha dëshirë të merrnit informacion nga pleqia. Ky është një proces që jam i paqartë.

B. Xhaferi: Toka bujqësore jepet sipas ligjit. Duhet ta kalojmë në parim.

A. Sula: Duhet të vilen të ardhurat që bashkia të zbatojë projekte për të zhvilluar komunitetin. Kjo është për t'u përgëzuar administrata.

A. Malaj: Ankandi zhvillohet nga komisioni që përbëhet nga anëtarë të disa insititucioneve.

A. Halili: Tek çështja e ditës tek p/vendimi është sipërfaqe 10500 me zone kadastrale 3111 duhet të jetë me numër zona kadastrale 10/25 sipas vërtetimit. Është lapsus ky?

F. Mushamati: Në lidhje me projektin është një komision që do t'i kalojë. Ne i kalojmë në parim.

A. Sula: Unë mendoj që fakti që s'ka konflikte kjo do të thotë që bashkia ka ndërhyrë dhe i ka zgjidhur, pra ka bashkëpunim me banorët.

A. Halili: Sipas ligjit bëhet me shpallje, nuk mbaron këtu procedura.

MEMALIAJ

Hidhet në votim.

Vota Pro 10

Vota Kundër -

Vota Abstenim - Miratohet.

Mbledhja mbyllet.

Këshilltarë pjesëmarrës.

1. Taulant Rama
2. Asqeri Muçoima
3. Arsola Muzha
4. Irena Jaupi
5. Esmerald Xhemali
6. Anest Halili
7. Lauresha Lila
8. Petrit Lumani
9. Maltona Bërxi
10. Flamur Mushamati
11. Erjon Sinanaj

Sekretari i Këshillit
Erjola Allka



Kryetari i Këshillit
Erjon Sinanaj

